

Nr.regj.14829/2012

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,  
Departamenti i Përgjithshëm  
Divizioni i Kundërvajtjes**

REPUBLIC OF KOSOVO AGENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCY AGAINST CORRUPTION	
Llopi	
Drejtori	DPK/DMP
Drejtori i Përgjithshëm	03-1787/13
Prirësi	
Shërbuesi	02
Mirënjohja	10.06.2013

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni i Kundërvajtjes,** me gjyqtarin Mustafë Selimi dhe procesmbajtësen Shqipe Hajdari, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Ilmi Zherka nga Gjakova, për kundërvajtje nga neni 6 par.1 nënpar.1.2, neni 8 par.1 lidhur me nenin 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, Ligji nr.04/L-050, e ne bazë të nenit 73,74,195,199 dhe konformë nenit 9 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I PANDEHURI:** Ilmi Sadik Zherka, i lindur më 1955 në Gjakovë ku dhe tani jeton rr."Kushtrim Hoxha" nr.6, i martuar, baba i një fëmije, për momentin i pa punë

**E s h t ë p ë r g j e g j ë s**

Sepse si zyrtar i lartë publik në Univerzitetin e Prishtinës-Prodekan në Fakultetin e Ndërtimtaris dhe Arkitekturës, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë në afatin e caktuar ligjor pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, edhe pse ka qenë në listen e zyrtarëve të Univerzitetit të Prishtinës për deklarimin e pasurisë për vitin 2012.

Me veprim të këtyllë ka kryer kundërvajtje nga neni 6 par.1 nënpar.1.2 dhe neni 8 par.1 lidhur me nenin 17 par.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat zyrtar Ligji nr.04/L-050, andaj për këtë konformë nenit 9 të LMK-së.

**G J O B I T E T**

Me gjobë në shumën prej 600(gjashtëqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së.No.1000 4300 7000 0518. Paga bëhet në ndonjë agjensi për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e nejta do të zavendsohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse ne emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EU, në shërbimin e arkës së Gjykatës. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë,** i parashtrori Gjykatës kërkesën nr.01-1612/2012 më dt.02.05.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Ilmi Zherka dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Me aktvendimin regj.nr.14829/2012 të dates 19.10.2012, të pandehurit Ilmi Zherka Gjykata i dha vetëm Qortim konformë nenit 10 të LMK-së, duke ia falur besimin e plotë deklaratës së tij se nuk ka qenë i njohtuar në mënyrë të rregullt, se nuk e ka ditur që gjendet në listen e zyrtarëve të Univerzitetit të Prishtinës për deklarimin e pasurisë për vitin 2012 dhe duke qenë ushtrues detyre i prodekanit të FNA për kohë të caktuar ka menduar se nuk është i obliguar ta deklarojë pasurinë pranë Agjencisë.

Në bazë të ankesës të ushtruar nga AKK, Kolegji i Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë e Abrogon aktvendimin e Gjykatës së shkallës së parë, dhe lëndën e kthen në plotësim procedure dhe rivendosje.

201782/13/132  
Me vlerësimin e procedurës konkurruese nr. 277/18 LMK, që dhe shpallim të të gjitha pjesëtarëve që kanë marrë pjesë në konkurrimin e kësaj lloji, gjykatës në dënim të kundërvajtjes, gjykatës gjyqësore të caktuar për datë 03.06.2013 u muar në pyetje në cilësi të dëshmitares sekretarja e FNA Valdete Shala, e cila dëshmoi se personalisht i ka dorëzuar profesor Zherkës formularin për deklarinimin e pasurisë dhe se deklarata e tij kinse nuk ka qenë i informuar nuk qëndron. Ky profesor nga funksioni i prodekanit në FNA ka dhënë dorëheqje më datë 31 Maj 2012, por në bazë të ligjit ka qenë i obliguar ta deklaroj pasurinë sepse sipas kontratës së punës i njëjti i ka pasur kompetencat e plota edhe pse në këtë detyrë ka qenë në kohë të caktuar.

Si profesor në UP ka punuar 26 vite dhe ka qenë shumë i përpiktë në punën e tij por kushtet ekonomike dhe udhëtimi nga Gjakova në Prishtinë e kanë shtyrë për të dhënë dorëheqje thekson kjo dëshmitare. Përfaqësuesja e autorizuar e AKK Valbona Zeqiri me rastin e marrjes në procesverbal deklaroi se pike kontaktuese për njohtim lidhur me deklarinimin e pasurisë së zyrtarëve të UP, Agjencia Kundër Korrupsionit e ka pasur Fidan Hamitin, nga i cili kanë kërkuar listen e zyrtarëve të këtij Univerziteti që kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë për vitin 2012, dhe sipas informacionit që kanë marrë që të gjithë këta zyrtarë në mesin e të cilëve edhe Ilmi Zherka kanë qenë në mënyrë të rregullt të informuar. I pandehuri për vitin 2010, e ka deklaruar pasurinë pranë Agjencisë në mënyrë të rregullt, derisa e ka ushtruar të njëjtën detyrë dhe arsyetimi i tij kinse nuk ka qenë i informuar për këtë obligim ligjor edhe për vitin 2012 nuk qëndron.

Nga vlerësimi i kërkesës së parashtruar, deklarata e të pandehurit si dhe dëshmitë e dëshmitarëve të përmendur më lartë, Gjykata me rastin e rivendosjes konstaton se i pandehuri e ka kryer kundërvajtjen ashtu siq e rëndon kërkesa për çka u shpall i fajshëm.

Pretendimet e të pandehurit kinse nuk ka qenë i informuar se gjendet në listen e zyrtarëve të UP, që kanë qenë të obliguar ta deklarojnë pasurinë për vitin 2012, u hodhën poshtë dhe nuk u morën për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit, sepse në bazë të dëshmisë së përfaqësueses të autorizuar të AKK dhe sekretares së FNA, Gjykata konstatoi se i pandehuri me kohë dhe në mënyrë të rregullt është informuar për këtë obligim ligjor. Megjithatë, gjendjen jo të mirë ekonomike të profesor Zherkës tani i pa punë, vetitë personale të tij dhe rrethanat në të cilat është kryer kundërvajtja, Gjykata i vlerësoi si rrethana lehtësuese për zbutjen e dënimit nën masën minimale të përcaktuar me ligj duke qenë i bindur se edhe me një dënim më të butë arrihet qëllimi i dënimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi ankesë mund ti ushtrohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh, prej ditës së marrjes së këtij aktvendimi nepërmes të kësaj Gjykate dhe pa taksa.

**VENDOSI GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTE NË PRISHTINË,**  
Me dt.05.06..2013

**GJYQTARI**  
Mustafë Selimi